

## Vendim nr. 307 datë 17.12.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimimi, anëtarë, në datën 16.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (L) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** LEONORA PURO

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2024-234, datë 22.02.2024; nr. 00-2024-263, datë 22.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja ka ushtruar aktivitetin e tregtimit të peshkut me pakicë në Durrës. Nga një kontroll i ushtruar aktivitetit të saj nga Dega e Tatim-Taksave Durrës (*DTTD*), bazuar në informacionin e sektorit fiskal të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*DPT*), ka rezultuar se kërkesja ishte furnizuar nga shoqëria “P.” sh.p.k. me një sasi peshku, të ndarë në 46 fatura tatimore shitjeje, me vlerë të përgjithshme prej 12,963,330 lekësh, për të cilën duhej të

paguante detyrimin tatimor në vlerën 464,468 lekë. Duke mos qenë dakord me vlerësimin tatimor, kërkuesja ka kundërshtuar aktin e njoftimit të detyrimit fillimisht në rrugë administrative përmes ankimit në Komisionin e Apelit të Tatimeve dhe Taksave (*KATT*), e më pas në rrugë gjyqësore me kërkesëpadi në gjykatat e zakonshme.

2. *KATT*-i ka vendosur mospranimin e ankimit, për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit ligjor dhe mosshoqërimit me dokumentacionin e duhur. Me vendimin nr. 861, datë 15.05.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe anulimin e aktit administrativ. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim DTTD-ja dhe me vendimin nr. 408, datë 17.07.2003, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e DTTD-së, me vendimin nr. 2062, datë 21.12.2004, ka vendosur prishjen e të dyja vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e gjykimit, me arsyetimin se padia nuk mund të ngrihej, pasi kërkuesja, në përmbushje të kërkesave të ligjit për procedurat tatimore, duhej të paguante më parë detyrimin tatimor prej 464,468 lekësh dhe më pas të ushtronte ankimin në rrugë administrative dhe vetëm në rastin e dhënies së një vendimi negativ nga *KATT*-i, ajo mund të ndiqte rrugën gjyqësore për kundërshtimin e detyrimit tatimor.

3. Pas përfundimit të procesit gjyqësor si më lart, në lidhje me ngarkimin e saj me detyrimin e mësipërm tatimor, kërkuesja, në vitin 2007, ka paraqitur kallëzim penal ndaj ortakes së vetme të shoqërisë “P.” sh.p.k., për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i formularëve dhe stampave”, të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal (*KP*), si dhe ndaj disa punonjëseve të Degës së Tatim-Taksave Tiranë, të cilat kishin ushtruar kontrollin pranë shoqërisë “P.” sh.p.k. dhe kishin përpiluar informacionin mbi bazën e të cilit, në vijim, kërkuesja u ngarkua me detyrimin tatimor. Në përfundim të hetimeve paraprake këto shtetase janë dërguar për gjykim për akuzën e kryerjes së veprës penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore”, parashikuar nga neni 181/a i *KP*-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1591, datë 26.06.2014, ka vendosur deklarin e tyre fajtores, sipas akuzës, me arsyetimin se punonjëset tatimore në fjalë nuk kanë evidentuar mangësinë në faturat tatimore të shitjes të lëshuara nga shoqëria “P.” sh.p.k., ndërsa në to qartësisht mungonte nënshkrimi i blerëses (kërkueses), çka përbënte mospërmbushje nga ato të detyrimit ligjor për vjeljen e tatimeve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 115, datë 01.02.2016, ndërsa mbi rekursin e të gjykuarave, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-1352 (163), datë 20.07.2016, ka vendosur prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta dhe pushimin e çështjes penale ndaj tyre. Sipas atij kolegji, legjislacioni tatimor në momentin ushtrimin të kontrollit pranë subjektit tatimor nuk parashikonte shprehimisht detyrimin e blerësit për të nënshkruar faturat tatimore, ndaj mosevidentimi si

shkelje nga ana e të pandehurave për këtë shkak nuk konsiderohet mospërbushje e detyrës së tyre funksionale edhe nëse do të ishin pikërisht ato personat që kishin për detyrë vjeljen e drejtpërdrejtë të detyrimit tatimor, pra të ishin subjekt i veprës penale për të cilën janë akuzuar.

4. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur disa kallëzime penale ndaj ekspertëve të thirrur gjatë procesit penal dhe, më pas, edhe ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që janë përfshirë në ato procese.

5. Konkretisht, kërkuesja ka kallëzuar penalisht shtetasit M.R. dhe A.B., të thirrur si ekspertë në gjykimin e çështjes penale në ngarkim të punonjëseve të organeve tatimore që kishin ushtruar kontrollin ndaj saj. Sipas kërkueses, ekspertët kishin kryer veprën penale “Ekspertimi i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i KP-së, pasi akti i ekspertimit i hartuar prej tyre nuk pasqyronte të vërtetën. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria Tiranë*) në datën 28.07.2017 ka regjistruar procedimin penal me nr. 5728. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria Tiranë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për pushimin e procedimit penal, konform nenit 329, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Me vendimin nr. 1189 të regjistrimit themeltar, datë 21.06.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorisë për vijimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga prokuroria, ndërsa kërkuesja ka bërë kundërankim. Me vendimin nr. 1950, datë 10.09.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

6. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, sipas detyrave të lëna nga gjykata, Prokuroria Tiranë i është drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për pushimin e procedimit penal. Me vendimin nr. 1189/1 të regjistrimit themeltar, datë 13.05.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur sërish rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorisë për vijimin e hetimeve. Sipas gjykatës, nga ana e prokurorisë duhej të bëhej një ekspertim shtesë nga të tjerë ekspertë, me qëllim që t’u jepej përgjigje pyetjeve të kërkueses. Ndaj ankimit të ushtruar nga prokuroria dhe shtetasi M.R., me vendimin nr. 974, datë 10.07.2019, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

7. Pas kryerjes së detyrave, sipas vendimit të dytë të gjykatës së rrethit, Prokuroria Tiranë ka paraqitur për të tretën herë kërkesë për pushimin e procedimit penal. Me vendimin nr. 452 të regjistrimit themeltar, datë 09.09.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorisë, duke urdhëruar ballafaqimin e kërkueses me ekspertët që kishin bërë shtesën e aktit të ekspertimit.

Kundër vendimit të gjykatës ka ushtruar ankim Prokuroria Tiranë, ndërsa kërkuesja kundërankim.

8. Me vendimin nr. 70, datë 16.02.2021, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 452 të regjistrimit themeltar, datë 09.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e procedimit penal nr. 5728/2017. Gjykata e apelit ka vlerësuar, ndër të tjera, se kallëzimi për ekspertim të rremë kishte të bënte me çështje të ligjit dhe jo çështje teknike, që zgjidhej nga ekspertët e fushës. Po sipas gjykatës, detyrat e lëna më herët prokurorisë nga gjykatat ishin përmbushur, ndaj kthimi sërish i akteve për të bërë ballafaqimin e kërkueses me ekspertët, ishte i pavend. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar rekurs.

9. Me vendimin nr. 00-2024-263, datë 22.02.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit kishte identifikuar drejt çështjet e ligjit, ndërkohë që nga prokuroria ishin kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore të kërkuara nga legjislacioni penal për një hetim objektiv e të paanshëm.

10. Po kështu, përmes një kallëzimi tjetër në vijim, kërkuesja ka kërkuar ndjekjen penale të një prokurori të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), të disa gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe të një prokurori të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen prej tyre të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Ajo ka kërkuar, gjithashtu, ndjekjen penale edhe të disa shtetasve, të cilët kanë kryer funksionin e ekspertit në procesin penal të pushuar, për kryerjen e veprës penale “Ekspertimi i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i KP-së. Pas trajtimit të këtij kallëzimi, Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronjat “ç” e “e” dhe 291, të KPP-së, me arsyetimin se nuk provohej ekzistenca e ndonjë fakti penal.

11. Kërkuesja ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, për të cilin, me vendimin nr. 113, datë 06.05.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*) ka vendosur rrëzimin e ankimit, duke vlerësuar se vendimi i prokurorisë ishte i drejtë dhe në përputhje me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas gjykatës, nga ana e prokurorit të Prokurorisë së Posaçme ishin zbatuar me përpikëri kërkesat ligjore të përcaktuara në vendimin unifikues. Po kështu, edhe veprimet e prokurorit të gjykatës së rrethit ishin kryer në përputhje me parashikimet ligjore. Pretendimet e kërkueses se nga ana e gjykatës së apelit ishin shkelur afatet procedurale ishin të pabazuara. Për më tepër, dhënia e vendimit jashtë afatit nuk përbënte shkak për procedimin penal, por për atë disiplinor. Nga ana tjetër, pretendimet e

kërkueses kishin të bënin me hamendësime dhe supozime, pa fakte dhe prova dhe problemet e ngritura ishin të natyrës juridikocivile, që nuk mund të zgjidheshin përmes kallëzimeve ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që kishin dhënë vendimet përkatëse, por përmes ankimit në rrugë gjyqësore.

12. Për ankimin e kërkueses, me vendimin nr. 152, datë 23.06.2021, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*) ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke e vlerësuar atë të drejtë në këndvështrim të parashikimeve ligjore në fuqi, sipas të cilave gjyqtari dhe prokurori nuk mbajnë përgjegjësi penale në ushtrimin e të drejtave ose në përmbushje të detyrave të tyre të caktuara me ligj.

13. Në vijim, kërkuesja ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të GJKKO-së së Apelit, si dhe ka paraqitur shtesë të tij. Me shkresën nr. 151 akti, datë 01.10.2021, ajo është njoftuar nga GJKKO-ja e Apelit në lidhje me detyrimin ligjor për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi. Në përgjigje të kësaj shkrese, kërkuesja ka pretenduar se ishte mbrojtur vetë edhe në shkallët e tjera të gjykimit dhe se nuk ishte në cilësinë e së pandehurës, ndaj nuk ndodhej në kushtet e nenit 435 të KPP-së.

14. Me vendimin nr. 00-2024-234, datë 20.02.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, sipas parashikimeve të nenit 435, pika 2, të KPP-së.

15. Në datën 17.09.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 07.10.2024.

## II

### Pretendimet e kërkueses

16. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

16.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

16.1.1. *Së drejtës së aksesit*, si rrjedhojë e vendimit nr. 00-2024-234, datë 20.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të saj, për shkak të mosnënshkrimit nga mbrojtësi.

16.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi nr. 70, datë 16.02.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. 5728/2017 me arsytimin se firma në fatura nuk ishte e domosdoshme, është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar (*ligji nr. 7928/1995*) dhe të udhëzimit nr. 4, datë 11.02.2002 të ministrit të Financave “Për tatimin mbi

vlerën e shtuar” (*udhëzimi nr. 4/2002*). Në kundërshtim me ligjin, një arsyetim i tillë i gjykatës së apelit është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 00-2024-263, datë 22.02.2024 të saj.

16.1.3. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi proceset gjyqësore në lidhje me faturat e paligjshme tatimore vazhdojnë prej 22 vjetësh.

16.1.4. *Parimit të ligjshmërisë*, për shkak të veprimeve të paligjshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve në shkelje të rregullave për mbajtjen e dosjes gjyqësore, të afateve dhe procedurave të hetimit dhe të interpretimit të drejtë të ligjeve.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuësja ka rezultuar humbëse në procesin gjyqësor administrativ që kishte për objekt ligjshmërinë e detyrimeve tatimore që i ishin

ngarkuar asaj. Ai proces është mbyllur me vendim pushimi nga Gjykata e Lartë në vitin 2004 (shih paragrafin 2 më lart). Vendimet e gjykatave në atë proces nuk janë objekt kontrolli në këtë proces kushtetues. Në këtë proces kushtetues kërkuesja ka kundërshtuar dy procese gjyqësore penale, të cilat janë përmblyllur me vendime për mospranimin e rekurseve të saj nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (vendimet nr. 00-2024-234, datë 20.02.2024 dhe nr. 00-2024-263, datë 22.02.2024). Proceset gjyqësore objekt ankimi kushtetues individual janë vënë në lëvizje bazuar në dy kallëzime penale të kërkueses ndaj: (i) ekspertëve që kanë përpiluar aktin e ekspertimit në gjykimin e çështjes penale në ngarkim të punonjëseve tatimore; (ii) prokurorëve e gjyqtarëve që kanë hetuar e gjykuar kallëzimet penale të saj, si dhe ekspertëve të marrë gjatë gjykimit të këtyre çështjeve. Në lidhje me kallëzimin e parë, Prokuroria Tiranë e ka kërkuar tre herë pushimin e procedimit penal. Në të tria rastet, gjykata e shkallës së parë (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorisë për veprime të mëtejshme hetimore. Pas rrëzimit për herë të tretë të kërkesës së prokurorisë, mbi ankimet e prokurorit dhe njërit prej ekspertëve, gjykata e apelit ka vendosur pushimin e procedimit penal sipas kërkesës së prokurorit, për shkak se kallëzimi kishte të bënte me çështje të ligjit dhe jo çështje teknike që mund të zgjidheshin nga ekspertët, si dhe se organi i prokurorisë kishte përmbushur detyrat e lëna. Kërkuesja ka ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin, duke vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj (vendimi nr. 00-2024-234, datë 20.02.2024).

20. Për sa i përket kallëzimit të dytë, Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se ekzistenca e faktit penal nuk provohej. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkueses kundër vendimit të mosfillimit, duke vlerësuar se veprimet e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ishin kryer në përputhje me parashikimet ligjore, ndërsa pretendimet e kërkueses ishin të pabazuara ose që nuk mund të zgjidheshin përmes kallëzimeve ndaj prokurove e gjyqtarëve, por përmes ankimit në rrugë gjyqësore. Më tej, ankimi i kërkueses është rrëzuar nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka vlerësuar se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ishte në zbatim të drejtë të ligjit, pasi gjyqtari dhe prokurori nuk mbajnë përgjegjësi penale në përmbushje të detyrave të tyre të caktuara me ligj. Rekursi i saj nuk është pranuar për shqyrtim nga Gjykata e Lartë, si rrjedhojë e mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, sipas parashikimeve të nenit 435, pika 2, të KPP-së, ndonëse kërkuesja ishte bërë me dije për këtë detyrim (nr. 00-2024-263, datë 22.02.2024).

21. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se procedimet penale ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve kanë në objektin e tyre të hetimit veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të

parashikuar nga neni 208 i KP-së, ndërsa ato ndaj ekspertëve veprën penale “Ekspertimi i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i po këtij kodi. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në bazë të kallëzimeve penale qëndron veprimtaria e kryer nga gjyqtarët e gjykatave të posaçme e të rrethit, si dhe prokurorët e prokurorive pranë këtyre gjykatave, përgjatë proceseve penale të vëna në lëvizje mbi kallëzimet e kërkuases në kuadër të mbrojtjes së interesave të saj pasurore, si rrjedhojë e vendosjes në ngarkim të saj të detyrimeve tatimore. Në lidhje me këto të fundit, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se me vendimin nr. 2062, datë 21.12.2004, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e të dyja vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e gjykimit, me arsyetimin se padia nuk mund të ngrihej, pasi kërkuësja, në përmbushje të kërkesave të ligjit për procedurat tatimore, duhej të paguante më parë detyrimin tatimor prej 464,468 lekësh dhe më pas të ushtronte ankimin në rrugë administrative dhe vetëm në rastin e dhënies së një vendimi negativ nga KATT-i, ajo mund të ndiqte rrugën gjyqësore për kundërshtimin e detyrimit tatimor.

22. Duke mbajtur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, Mbledhja e Gjyqtarëve do të verifikojë, së pari, se cila e drejtë kushtetuese substanciale e kërkuases vihet në diskutim në këtë kontekst. Më tej, Mbledhja e Gjyqtarëve do të verifikojë nëse vendimet e gjykatave kundër të cilave ankohet kërkuësja kanë sjellë pasoja negative mbi atë të drejtë. Në këtë mënyrë Mbledhja e Gjyqtarëve do të arrijë në një përfundim nëse kërkuësja ka statusin e viktimës në raport me vendimet gjyqësore të konstestuar dhe, për rrjedhojë, legjitimohet *ratione personae* për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

23. Nën këtë prizëm, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pretendimet e kërkuases janë fokusuar tek antikushtetutshmëria e vendimeve gjyqësore në proceset penale të cilat ajo i ka vënë në lëvizje pasi ka humbur me vendim gjyqësor përfundimtar (vendimi nr. 2062, datë 21.12.2004 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë) të drejtën e pretenduar për anulimin e detyrimeve tatimore të vendosura në ngarkim të saj nga organet tatimore. Duke pasur parasysh natyrën e mosmarrëveshjes midis kërkuases dhe organeve tatimore, e cila ka të bëjë me detyrime me natyrë monetare, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se e drejta substanciale kushtetuese e kërkuases që vihet në diskutim në këtë kontekst, përfshihet në konceptin e pasurisë dhe të pronës private. Duke qenë se interesi substancial i kërkuases lidhet me të drejtën e pronës private, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuësja nuk ka argumentuar se në çfarë mënyrë vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej saj në këtë proces kushtetues (vendimet nr. 00-2024-234, datë 20.02.2024 dhe nr. 00-2024-263, datë 22.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë) kanë cenuar të drejtën e saj për pronë private të mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se rivendosja e së drejtës së pronës private që pretendohet se është cenuar, në rastin konkret, nuk duket se varet nga mënyra e përfundimit të



proceseve penale të kontestuara. Kjo do të thotë se edhe në rastin e një vendimi penal në favor të kërkueses, mjeti i përdorur prej saj nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes së të drejtës substanciale.

24. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për pasojë ankimi kushtetues individual i saj nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash<sup>1</sup>,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

---

<sup>1</sup> Gjyqtaret Sonila Bejtja dhe Marjana Semini votuan për kalimin e çështjes në seancë plenare me arsyetimin se ankimi kushtetues individual i kërkueses i plotëson kriteret e legjitimitimit dhe se pretendimet e ngritura nga ajo nuk janë haptazi të pabazuara.